



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 11.3.2024

Lënda: Parashtrimet e Komisionerit Publik lidhur me *kërkesën e ish-subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (JR) nr. 6, datë 28.2.2019*

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, neni 65, pika 1, neni 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me shkresën nr.***/** prot., datë 19.2.2024, ka njoftuar Institucionin e Komisionerëve Publikë (IKP), se më datë 11.3.2024, ora 10.00, do të gjykojë në seancë publike *kërkesën e ish-subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (JR) nr. 6, datë 28.2.2019*. Sa më sipër, Kolegji ka përcjellë në IKP: “Shpallje e njoftimit për gjykimin e çështjes në seancë publike”, *kërkesën për rishikimin e vendimit, si dhe aktet bashkëlidhur saj.*

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera, *i ka dhënë mundësinë Institucionit të Komisionerëve Publikë të dëgjohet dhe të mbajë qëndrimin e tij lidhur me kërkesën për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (JR) nr. 6, datë 28.2.2019.*

Referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë¹, gjykimi në seancë gjyqësore në këtë rast, *nuk është një gjykim themeli, por një seancë dëgjimore, ku secila nga palët pjesëmarrëse në gjykim, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, paraqet argumente rreth shkaqeve që ligji kërkon për rishikimin*. Sa më sipër, Komisioneri Publik, në analizë të akteve të përcjella nga Kolegji dhe bazës ligjore të aplikueshme, vëren se:

¹ Referuar vendimit nr.1, datë 31.1.2006, ku Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, janë shprehur për efekt të ndryshimit të praktikës gjyqësore, si rezultat i vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 18.7.2005, i cili ka shfuqizuar si antikushtetues vendimin nr.17, datë 10.3.2004, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

1. Kërkuesja, Antoneta Sevdari, ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, dhe për rrjedhojë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* dhe me përparësi në kohë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 279, pika 4 e ligjit nr. 115/20161, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, duke qenë se ishte candidate për anëtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

1.1 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 42, datë 18.7.2018, ka vendosur “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, me funksion prokurore në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.”

1.2 Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, dhe F, pika 2 të aneksit të Kushtetutës, më datë 29.8.2018, ka ushtruar ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 42/2018, për subjektin e rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, duke kërkuar përfundimisht: “*Ndryshimin e vendimit nr. 42, datë 18.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit*”.

1.3 Kolegji i Posaçëm i Apelit, me vendimin nr. 6, datë 28.2.2019, me shumicë votash, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, në nenin 61, pikat 3 dhe 5, si dhe në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. 42, datë 18.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari*”.

1.4 Kërkuesja, Antoneta Sevdari, ka paraqitur ankim pranë Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut² (GJEDNJ), e cila, me vendimin nr. 40662/19, datë 13.12.2022, ndër të tjera, ka vendosur se: [...] *E deklaron, unanimisht, të pranueshme ankesën sipas nenit 8 të Konventës për shkarkimin e kërkuarës; 2. E deklaron, me shumicë, pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme; 3. Gjykon, unanimisht, se është shkelur neni 8 i Konventës për sa i përket shkarkimit të kërkuarës... 5. Rrëzon, unanimisht, pjesën tjetër të kërkesës së kërkuarës për shpërblim të drejtë [...].*

1.5 Vendimi i GJEDNJ ka marrë formë të prerë më datë 13.3.2023, pasi nuk është kërkuar kalimi i çështjes në Dhomën e Madhe, sipas nenit 43 të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut. Nga aktet, duket se kërkuarësja ka marrë dijeni për vendimin më datë 15.3.2023, bazuar në njoftimin që Gjykata ka dërguar në adresën elektronike të përfaqësuesit të saj.

1.6 Në vijim, më datë 12.4.2023, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, është regjistruar çështja nr. 42-17/2018 (JR), datë 11.4.2023, që i përket kërkuarës Antoneta Sevdari, me objekt: “*Rishikimin e Vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 6, datë 28.2.2019*”.

2. Komisioneri Publik vëren se, referuar përmbajtjes së nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare, Gjykata Kushtetuese funksionon me dy kolegje. Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, organet e rivlerësimit ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Ai konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e rivlerësimit dhe të drejtat, dhe

² Referuar nenit F, pika 8 e aneksit të Kushtetutës, subjektet që rivlerësohen, mund të ushtrojnë ankim në Gjykatën Europiane e të Drejtave të Njeriut.

garancitë e përfshira në skemën legjislative dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera (shihni vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese).

2.1 Referuar kuadrit ligjor të zbatueshëm, si dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese³, vlerësojmë se juridiksioni i Kolegjit, në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual për çështje që i përkasin rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, është i përcaktuar nga vetë Kushtetuta, ndaj pretendimet që kanë të bëjnë me vendimmarrjen e këtyre organeve, qofshin të natyrës kushtetuese, janë objekt shqyrtimi në këtë Kolegj. Në rastin konkret, Kolegji, në juridiksionin e rivlerësimit, është dhe gjykata më e lartë që ka shqyrtuar çështjen e kërkuases, në themel.

2.2 Lidhur me shkaqet ligjore të kërkesës për rishikim, Komisioneri Publik vlerëson se kjo kërkesë përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Në këtë kuadër, Komisioneri Publik, në raport me legjislacionin e zbatueshëm⁴, vëren se rasti i referuar në kërkesën për rishikim, ka të bëjë me faktin se GJEDNJ ka gjetur shkelje të konventës europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe të protokollove të saj, sipas nenit 494, germa “ë”, të K. Pr. civile”.

2.3 Sa më sipër parashtruar, lidhur me anën formale të kërkesës për rishikim të znj. Sevdari, Komisioneri Publik vlerëson se kërkuësja, Antoneta Sevdari, legjitimohet për t’iu drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pasi, referuar legjislacionit të zbatueshëm, kërkesa është paraqitur brenda afatit kohor, përmban një përmbledhje të vendimit të gjykatës ndërkombëtare me çështjet kryesore që ka konstatuar kjo gjykatë, si dhe ka kërkimet konkrete në fund të kërkesës.

2.4 Në përfundim, referuar situatës faktike të kërkuases, znj. Sevdari, Komisioneri Publik konstaton se shkaqet e kërkesës për rishikim kanë të bëjnë *me kundërshtimin e përmbajtjes së vendimit nr. 6/2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me përmbajtjen e një vendimi tjetër nr. 40662/19, datë 13.12.2022, të GJEDNJ-së,*⁵ dhe lidhen me shqyrtimin në fakt të së njëjtës çështje gjyqësore dhe së njëjtës situatë faktike të paraqitur në ankimin e Komisionerit Publik, të datës 29.8.2018, shqyrtuar më parë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit. Për rrjedhojë, Komisioneri Publik çmon *se mbetet në vlerësim dhe kompetencë të Kolegjit, vendimmarrja mbi kërkesën për rishikimin e vendimit të tij dhe themelësinë e saj.*

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO

³ Referuar vendimit nr. 39/2023, të Gjykatës Kushtetuese.

⁴ Ashtu sikurse dhe Kolegji ka interpretuar në jurisprudencën e tij (JR nr. 3/2018), ligji nr. 84/2016 parashikon, në nenin 4, pika 6, se: Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji. Parimet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile mund të zbatohen në këtë proces vetëm për çështje të parregulluara në mënyrë specifike nga legjislacioni, si më sipër cituar.

⁵ Referuar nenit 71/c, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 (të ndryshuar), “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 494, shkronja “ë” e K. Pr. Civile.